



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:074212

Datë: 28.04.2021

Numri i dokumentit: 01740098

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1021/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari Ertan Sejfulla, me sekretaren juridike Sadije Sogojeva, në çështjen penale ndaj të pandehurit M. G., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.987/21 të dt. 19.04.2021, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më dt.28.04.2021, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.987/21 të dt. 19.04.2021, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: M. G., nga babai K. dhe nëna Xh., e gjinisë V., i lindur me datë (Data e lindjes...), në P., me vendbanim në rrugën “Sh. K.”, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pamartuar, i papunë, më Nr. perosnal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me dt.04.03.2021, rreth orës 21:30, në Prishtinë, përkatësisht në rrugën “H. J.”, zyrtarët policor fillimisht kanë ndaluar të pandehurin M. G. dhe gjatë kontrollës ikanë gjetur substancë narkotike e llojit marihuanë, më peshë të përgjithshme prej 0.33 gram, të cilën ipandehuri e ka poseduar pa autorizim,-

- me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495, të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **100.00** (njëqind) €, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **30.00** (tridhjetë) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I konfiskohet të pandehurit substanca narkotike e llojit kanabis (marihuanë), me peshë prej 0.33 gram.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.987/21 të dt. 19.04.2021, ndaj të pandehurit M. G., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPP-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë në bazë të kallëzimit penal nr.2021-AB-0496, të datës 08.03.2021, Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të dt.04.03.2021, raporti i ekspertimit laboratorik i dt.01.04.2021, deklarata e të pandehurit, foto-dokumentacioni përfshirë edhe shkresat tjera të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri M. G., është penalisht përgjegjëse për kryerjen e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit, i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2.1 dhe par. 2.6 të KPP-së.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike është marrë në bazë të nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1021/21, i dt.28.04.2021

Sekretarja juridike,
Sadije Sogojeva

Gjyqtari,
Ertan Sejfulla

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.